

VENDIM
Nr.349, datë 10.6.2005

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISION VENDOR PRIVAT “TV BERATI”
SUBJEKTIT: Z. NAUN SHTREPI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.337, datë 20.5.2005, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit fizik z.Naun Shtrepi, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve analogjike tokësore, për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin e Beratit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj